



Ne baze te nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja (d) nenit 17, paragrafi 1, shkronja (f) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 15, paragrafi 1 pika 1.9 lidhur me paragrafin 8, e në mbështetje të nenit 34, paragrafi 7, të Ligjit Nr-04/L-060, për mbeturina “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-17/2012”), neneve 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR KLASIFIKIMIN DHE RICIKLIMIN E
MBETURINAVE KOMUNALE

Neni 1

1.1 Me këtë vendim caktohet lokacioni **për klasifikimin dhe riciklimin e mbeturinave komunale**, në pjesën e parcelës kadastrale **P-72116045-01846-3**, me sipërfaqe të përgjithshme prej; **199998m²**, sipas certifikatës së pronës **nr.120/2018**, datës 24.04.2018, zona kadastrale **Studençan**, vendi i quajtura **“Sllatina”** e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal-Suharekë.

1.2 Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës e cekur në piken 1, të nenit 1, të këtij vendimi ndahen **15000m²** **për klasifikimin dhe riciklimin e mbeturinave komunale** dhe i ndërrohet destinimi i paraparë edhe me PZHK nga tokë bujqësore-kullosë në hapësirë me përmbajtje publike, menaxhimi i mbeturinave komunale, ndërsa pronari i përhershëm mbetet Kuvendit Komunal-Suharekë.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis dhe Drejtoria për Shërbime Pronësore-Juridike dhe Kadastër e Komunës së Suharekës, të cilat do të bëjnë parcelizimin dhe skicimin në teren dhe regjistrimin e gjendjes në librat kadastrale.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr. 01/2016, për shqyrtimin administrativ te akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____

Me datë _____

Kryesuesi Kuvendit

Bexhet KUÇI